



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1669/12 prot.

Tiranë, më 31.10.2022

VENDIM

Nr. 49, datë 31.10.2022

“MBI MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE SUPLEMENTARE TË STAFIT AKADEMIK TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË REHABILITIMIT DHE INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UST, në VKM nr.748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IPAL” të ndryshuar pika 7, në Udhëzimin e MASR nr. 29 datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, në shkresën e FSHR nr. 1297/2 Prot, dt.18.10.2022, në shkresën e IKSHS nr. 1610 Prot, dt. 18.10.2022, në Vendimin e Senatit nr.87 datë 19.10.2022 “Për miratimin e propozimit për pagesën e orëve suplementare të stafit akademik të FSHR dhe IKSHS, për vitin akademik 2021-2022”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 31.10.2022,

V E N D O S I:

1. Miratimin për pagesën e orëve suplementare të stafit akademik të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nga art. 600.8 i buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës i planifikuar në miratimin e grantit për vitin buxhetor 2022.
2. Miratimin për pagesën e orëve suplementare të stafit akademik të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit nga art. 600.8 i buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës i planifikuar në miratimin e grantit për vitin buxhetor 2022.
3. Për stafin akademik që u është miratuar grada apo titulli gjatë vitit akademik, të identifikohen orët që janë kryer pas këtij ndryshimi dhe të përcillen nga Njësitë Kryesore për pagesë të specifikuara.
4. Bashkangjitur dokumentacioni përkatës nga të dy Njësitë Kryesore.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, Administratori, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

